



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:310540

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06738256

**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në lëndën penale kundër të pandehurit Xh.Rr. me numër të letërnjoftimit ... për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 par 1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1895/2024, të datës 31.10.2024, si dhe bazuar në nenin 15 paragraf 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim më datë 21.01.2025 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. APROVOHET marrëveshja e arritur në procedurë të ndërmjetësimit** në lëndën **P.nr.337/2024** dhe me numër të marrëveshjes **ND: 9/2025**, e arritur me datën 21.01.2025 e pranuar nga gjyqtari me datë 21.01.2025, për të pandehurin e cekur si në pjesën hyrëse të këtij aktvendimi.
- Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
- Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse dhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
- Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë gjyqësore.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI –  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**

2024:310540, 21.01.2025

**Gjyqtari  
Agron Maxhuni**

